



Urdhri
i Stomatologut të Shqipërisë

RREGULLORE PËR GJYKIMIN DISIPLINOR PROFESIONAL NË USSH

2022

Shtëpia Botuese: **MORAVA**
ISBN 978-9928-208-86-6

© Copyright USSH, 2019
Adresa: Rruga “Dritan Hoxha”, Pallati Konkord
Hyrja 7, Kati 6, Ap. 1-2, Tiranë - Shqipëri
Tel: 069 27 45358
Email: info@ussh.org.al
www.ussh.org.al

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi i kësaj Rregulloreje

1. Ky objekt i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë rregulla më të detajuara për zhvillimin e procedurave disiplinore të Urdhrit të Stomatologëve të Shqipërisë për shqyrtimin e çështjeve disiplinore të zhvilluara nga ky i fundit ndaj stomatologëve.
2. Procedura disiplinore garanton ushtrimin e profesionit të stomatologut në mbrojtje të të drejtave të tij, të pacientit si dhe të çdo subjekti tjetër që lidhet me këtë profesion. Funksionimi i procedurës disiplinore ndaj stomatologut garantohej nga dispozitat e ligjit “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nga dispozitat e kësaj Rregulloreje.
3. Qëllimi i procedurës disiplinore është sigurimi i ruajtjes së standarteve të domosdoshme në ushtrimin e profesionit të stomatologut dhe marrjen e masave disiplinore ndaj stomatologëve anëtarë të Urdhrit të Stomatologëve të Shqipërisë (në vijim USSH) që shkelin dispozitat e ligjit për ushtrimin e profesionit të stomatologut në drejtim të etikës, gabimeve profesionale, ose të Kodit Etik Deontologjik Stomatologjik.

Neni 2

Parimet e procedurës disiplinore në USSH

1. Urdhri i Stomatologut në Republikën e Shqipërisë, në ushtrimin e funksioneve të parashikuara në ligj, udhëhiqet dhe synon zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, si dhe parimet e mëposhtme:
 - a) e drejta për një proces të rregullt, duke përfshirë marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm;
 - b) parimin e ligjshmërisë, në kuptimin që komisioni kompetent disiplinor i USSH ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore prej stomatologut;
 - c) parimin e akuzës, në kuptimin që çdo individ, institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që ka ndodhur një shkelje disiplinore;
 - ç) parimin e barazisë para ligjit;
 - d) prezumimin e pafajësisë;
 - dh) parimin e proporcionalitetit;
 - e) parimin e pavarësisë dhe paanësisë së komisioneve disiplinore të USSH;
 - ë) parimin e konfidencialitetit dhe të drejtën e jetës private dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
2. USSH pranon dhe ndërmerri veprime për procedurën disiplinore vetëm për çështje që i

përkasin misionit dhe kompetencave të saj, të përcaktuara në ligj dhe në Statut.

Neni 3

Veprimi disiplinor për anëtarë të USSH-së shtetas të huaj

1. Stomatologët shtetas të huaj të cilët ushtrojnë profesionin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohen procedurës disiplinore në përputhje me këtë Rregullore sikundër të gjithë anëtarët e USSH-së me shtetësi shqiptare. Në çdo rast ata janë të detyruar të ndjekin procedurën disiplinore së bashku me përkthyesin e zgjedhur dhe të paguar prej tyre.
2. Masa disiplinore e vendosur ndaj tyre i njoftohet organit homolog të vendit përkatës (Urdhrit, Dhomës apo Shoqatës respektive).

KREU II

SHKAQET E PROCEDURËS DISIPLINORE DHE ANKIMI

Neni 4

Shkaqet për fillimin e procedurës disiplinore

1. Stomatologu, anëtar i USSH-së, i nënshtrohet procedurës disiplinore dhe marrjes së masës disiplinore për këto shkaqe:
 - a) kur kompetenca ose performanca profesionale

- e tij/e saj ka mangësi serioze;
- b) kur ndaj tij ka një ankim për mjekim të pakujdesshëm ose sjellje profesionale të padenjë;
 - c) kur është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë;
 - ç) kur për shkak të gjëndjes shëndetësore bëhet i paaftë ose i papërgjegjshëm për të ushtruar profesionin;
 - d) kur refuzon të zbatojë vendimet, urdhërat, udhëzimet që miratohen nga USSH apo refuzon paraqitjen e tij/e saj kur i kërkohet nga cfarëdo instance e USSH;
 - dh) kur stomatologu ose ndihmësstomatologu punon në kushtet kur i ka përfunduar afati i lejes së ushtrimit të profesionit ose nuk është pajisur anjëherë me licensë;
 - e) kur stomatologu ose subjekti juridik që përfaqëson pronësinë e klinikës zhvillon reklamë në median e shkruar, median sociale, median audiovizive ose nëpër portale me çmime konkrete të tarifave në shërbimin dentar.
 - f) në rastet kur stomatologu, anëtar i ussh-së nuk ka paguar kuotizacionin mbi 1 vit.
2. Kur çështja për të cilën ka filluar procedura disiplinore i është referuar njëkohësisht edhe organeve të sistemit të drejtësisë, USSH kryen të gjitha veprimet sipas kësaj rregulloreje duke krijuar dosjen e procedimit disiplinor për çështjen. Nga ky moment ose nëse në një fazë të mëvonshme

cështja paraqitet në organet e sistemit të drejtësisë, pezullohet procedura disiplinore e cila mund të vijojë nëse ka arsye, pas marrjes së vendimit të formës së prerë nga organet e sistemit të drejtësisë.

Neni 5

Pranimi i ankesave

1. Ankesa për fillimin e procedurës disiplinore ndaj një stomatologu që ushtron profesionin në Republikën e Shqipërisë dhe që është anëtar i USSH mund të paraqitet nga:
 - a) pacientë, familjarë të tyre, ose nga shtetas të tjerë;
 - b) Ministria përgjegjëse për fushën e shëndetësisë ose institucione të tjera shëndetësore publike apo private;
 - c) institucione jo shëndetësore të administratës publike apo sektorit privat;
 - ç) anëtarë të USSH ose të profesioneve të tjera të lidhura me shëndetin;
 - d) organet e mas-medias të shkruar ose medias audiovizive;
 - e) Presidenti i Këshillit Kombëtar të USSH-së.
2. Ankesa për fillimin e procedurës disiplinore, si rregull, duhet të paraqitet me shkrim tek Këshilli Rajonal përkatës në të cilin stomatologu është anëtar. Në rast se paraqitet tek zyrat qëndore të USSH, Sekretari i Përgjithshëm i USSH ia përcjell ankesën brenda 24 orësh komisionit disiplinor rajonal kompetent për shqyrtimin e kërkesës.

3. Në rast se kërkesa paraqitet në mënyrë verbale, një punonjës i USSH ndihmon ankuesin duke zbardhur atë me shkrim, fjalë për fjalë sipas shprehjeve të ankuesit, dhe një fakt i tillë evidentohet në ankesën përkatëse.
4. Në rast se ankuesi preferon të mbetet anonim duhet ta shprehë këtë gjë në mënyrë taksative së bashku me arsyet përkatëse. Në këtë rast administrata e USSH merr masat për mbrojtjen e të dhënave personale të tij gjatë procedurës disiplinore.

KREU III

PROCEDURA DISIPLINORE

Neni 6

Organet në procedurën disiplinore

1. Procedura disiplinore ndaj stomatologut, sipas ligjit dhe kësaj Rregulloreje, zhvillohet në dy nivele:
 - a) Shkalla e parë e cila zhvillohet pranë Këshillit Rajonal të USSH.
 - b) Shkalla e dytë e gjykimit profesional zhvillohet pranë Këshillit Kombëtar të USSH.
2. Komisioni Disiplinor Rajonal përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët një është jurist. Komisioni Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar përbëhet nga 9 anëtarë, nga të cilët një është jurist. Prezenca e anëtarit jurist në mbledhjet dhe vendimmarrjet e komisioneve disiplinore është kriter i

domosdoshëm.

3. Komisioni Disiplinor Rajonal dhe Komisioni Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar i zhvillojnë mbledhjet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të tyre dhe i marrin vendimet me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tyre.
4. Kryetari i Komisionit Disiplinor Rajonal dhe Kryetari i Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar duhet të jenë stomatolog.
5. Komisionet disiplinore në të dy nivelet në rast se çështja është e ndërlikuar ose nevojiten në vlerësimin e saj njohuri të specializuara në fushat mjekësore të veçanta kanë të drejtë të angazhojnë pranë tyre ekspertë të jashtëm. Mënyra e përzgjedhjes së ekspertëve të jashtëm, kushtet kontraktuale të shërbimit dhe masa e shpërblimit të tyre përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar.

Neni 7

Formimi i komisioneve disiplinore dhe afati i qëndrimit në detyrë

1. Anëtarët dhe kryetari i Komisionit Disiplinor Rajonal zgjidhen me votim të hapur nga këshilli rajonal, me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.
2. Anëtarët dhe kryetari i Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar zgjidhet me votim të hapur nga Këshilli Kombëtar, me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.

3. Anëtarët dhe kryetari i Komisionit Disiplinor Rajonal dhe Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar zgjidhen ne detyrë për një afat kohor 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje.
4. Përkatësisht këshilli rajonal dhe Këshilli Kombëtar për cdo nivel komisioni zgjedh edhe dy anëtarë zëvendësues, të cilët plotësojnë përbërjen e komisioneve disiplinore kur krijohet vakancë ose ka konflikt interesi të anëtarit sipas nenit 10 të kësaj Rregulloreje.
5. Propozimet për anëtar dhe kryetar të Komisionit disiplinor rajonal mund të bëhen me shkrim nga Presidenti i këshillit rajonal ose të paktën 4 anëtarë të tij, ndërsa propozimet për anëtar dhe kryetar për Komisionin Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar mund të bëhen me shkrim nga Presidenti i USSH ose të paktën 7 anëtarë të tij.

Neni 8

Krieret lejuese dhe ndaluese per kandidim

1. Anëtarët e Komisionit Disiplinor Rajonal dhe të Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar duhet të plotësojnë kushtete e mëposhtme:
 - a) të kenë përvojë jo më pak se 5 vjet në ushtrimin e profesionit (për stomatologët e përgjithshëm) dhe mbi 3 vjet pune për stomatologët e specializuar;
 - b) të kenë reputacion etiko-moral dhe profesional;
 - c) mundësisht të ketë përvojë në veprimtari administrative;

2. Nuk mund të kandidojnë dhe të zgjidhen anëtarë të Komisionit Disiplinor Rajonal dhe të Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar stomatologë dhe juristë të cilët:
 - a) gjatë pesë viteve të fundit janë ndëshkuar për shkelje disiplinore në ushtrimin e profesionit;
 - b) ndaj tyre është rregjistruar një procedim penal.
 - c) ushtrojnë funksione drejtuese në cdo nivel në një parti politike.

Neni 9

Lirimi nga detyra i anëtarëve të komisioneve disiplinore

1. Anëtari dhe kryetari i Komisionit Disiplinor Rajonal dhe Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar lirohet nga detyra para kohë kur:
 - a) paraqet dorëheqjen me shkrim;
 - b) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
 - c) mbështetur në rrethana faktike dhe të qarta rezulton se shpërdoron pozitën në Komision ose i shmanget gjykimit objektiv;
 - ç) mungon tre here rresht, pa shkaqe të përligjura, në seancat e gjykimit profesional;
 - d) bëhet i paaftë për arsye shëndetësore të ushtrojë këtë detyrë.

Presidenti i USSH është kryetar i Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar, ndërsa Presidenti i Këshillit Rajonal është kryetar i Komisionit Disiplinor Rajonal.

2. Propozimi për lirimin e parakohshëm të anëtarit ose kryetarit të Komisionit Disiplinor Rajonal bëhet nga Presidenti i këshillit rajonal ose kryetari i komisionit për Komisionin Disiplinor rajonal dhe miratohet nga këshilli rajonal, ndërsa për Komisionin Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar propozimi bëhet nga Presidenti i Këshillit Kombëtar ose kryetari i komisionit disiplinor pranë Këshillit Kombëtar, dhe miratohet nga Këshilli Kombëtar.
3. Anëtari i Komisionit Disiplinor i larguar para kohe zëvendësohet në këtë detyrë deri në përfundim të mandatit nga zëvendësuesi i pare i zgjedhur sipas nenit 7 të kësaj Rregulloreje.

Neni 10 **Konflikti i interesit**

1. Anëtari i Komisionit Disiplinor Rajonal ose i Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore, për veten ose për një anëtar tjetër, lidhur me një procedurë disiplinore, në përputhje me nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative, është i detyruar për sa më poshtë:
 - a) të deklarojë natyrën e interesit ose pengesës;
 - b) të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse;
 - c) të mos marrë pjesë në votimin e çështjes përkatëse.
2. Formulari i deklaramit të konfliktit të interesit miratohet me vendim të Këshillit Kombëtar.

KREU IV

PROCESI I GJYKIMIT DISIPLINOR

Neni 11

Gjykimi në Komisionin Disiplinor Rajonal

Për çdo ankesë të mbërritur në Komision fillohet procesi disiplinor sipas kësaj procedure:

1. Sekretari i Këshillit Rajonal, pasi verifikon brenda 24 orësh kushtet formale të pranueshmërisë sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje, regjistron ankesën në Regjistrin e Ankesave, dhe ia paraqet Kryetarit të Komisionit Disiplinor Rajonal. Format i Regjistrit të Ankesave miratohet me urdhër të Presidentit të USSH. Për ankesën e regjistruar njoftohet edhe presidenti i këshillit rajonal.
2. Kryetari i Komisionit Disiplinor Rajonal, nëpërmjet Sekretarit të Këshillit rajonal njofton pa vonesë të gjithë anëtarët e Komisionit për ankesën e paraqitur, dhe cakton me shkrim, sipas radhës, në varësi të ngarkesës së numrit të çështjeve, një nga anëtarët e tij si Relator të çështjes.
3. Mosushtrimi i detyrës së relatorit të çështjes pa shkaqe të ligjshme përbën shkelje admisnitrative dhe passjell përjashtimin e tij si anëtar i komisionit disiplinor dhe fillimin e procedurës disiplinore sipas kësaj Rregulloreje.
4. Relatori i çështjes dhe sekretari i këshillit rajonal janë përgjegjës për ndjekjen e procedurave administrative në lidhje me njoftimin e palëve dhe respektimin e afateve të gjykimit disiplinor. Sekretari i Këshillit Rajonal njofton zyrtarisht

stomatologun e paditur për ankesën e ardhur kundër tij, duke e njohur atë me:

- a) përmbajtjen e ankesës;
 - b) të drejtën që brenda 15 ditëve të paraqesë me shkrim qëndrimin e tij dhe provat në favor të tij dhe të cilat kërkon të administrohen në gjykim;
 - c) të drejtën për tu përfaqësuar në procedurën disiplinore kundër tij nga një stomatolog i të njëjtit specialitet ose avokat;
 - d) të drejtën për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore që do të zhvillohet ndaj tij.
5. Relatori ka të drejtë t'i kërkojë palës ankuese çdo informacion plotësues lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë dhe të kërkojë nga pala ankuese që të paraqesë çdo provë që e çmon të arsyeshme për vërtetimin e këtyre pretendimeve. Pala ankuese njihet gjithashtu me të drejtën për tu përfaqësuar dhe mbrojtur nga një avokat i licencuar dhe detyrimin për të qënë prezent në seancën dëgjimore nëse Komisioni Disiplinor Rajonal çmon si të domosdoshme një gjë të tillë.
6. Relatori i çështjes ka të drejtë të kërkojë nga palët çdo dokument apo provë tjetër shtesë që e gjykon të nevojshme, si dhe ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë çdo institucioni shëndetësor publik ose privat, për të marrë çdo të dhënë, që e konsideron të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Këta të fundit duhet të kthejnë përgjigje për kërkesat e paraqitura brenda 10 ditësh nga marrja e kërkesës së relatorit.

7. Pasi ka mbledhur të gjithë pretendimet, parashtrimet dhe provat, relatori harton, si rregull, brenda 30 ditësh nga regjistrimi i ankesës Raportin me shkrim mbi Verifikimin e Çështjes, dhe e depoziton atë që të shpërndahet tek anëtarët e tjerë të këshillit Disiplinor Rajonal.

Neni 12

Procedurat paraprake

1. Brenda 5 ditëve nga depozitimi i Raportit mbi Verifikimin e Çështjes zhvillohet seanca dëgjimore që bëhet me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Komisionit Disiplinor Rajonal.
2. Anëtarët e Komisionit Disiplinor Rajonal dhe palët lajmërohen nga kryetari i Komisionit për datën dhe orën e seancës dëgjimore dhe çështjen, që do të gjykohet, jo më vonë se 48 orë, para datës së caktuar për seancën dëgjimore, me çdo mjet komunikimi nëpërmjet të cilit konfirmohet marrja e njoftimit.
3. Pasi njihet me relacionin e përgatitur nga relatori, Komisionit Disiplinor Rajonal, nëse e çmon të nevojshme, mund të vendosë marrjen e provave të tjera dhe të shtyjë seancën dëgjimore ose të përcaktojë datën e zhvillimit të seancës dëgjimore me palë jo më vonë se 10 ditë.
4. Gjykimi disiplinor duhet të përfundojë jo më vonë se 70 ditë nga dita e dorëzimit të ankesës. Mospërfundimi i gjykitimit brenda këtij afati mund të ndodhë vetëm për çështje komplekse të cilat

kërkojnë një kohë më të gjatë për shqyrtimin e tyre. Zgjatja e afatit të procedurës disiplinore vendoset në mënyrë të arsyetuar nga këshilli disiplinor rajonal dhe bëhet publike.

Neni 13

Zhvillimi i seancës dëgjimore

1. Seancën dëgjimore e drejton Kryetari i Komisionit Disiplinor Rajonal, i cili i jep fjalën relatorit të paraqesë një përmbledhje të shkurtër të çështjes në procedurën disiplinore.
2. Në vijim i jepet fjala palës që ka paraqitur ankimin për të paraqitur ankesën e saj, si dhe nëse ka për të paraqitur, apo dorëzuar prova të tjera në lidhje me çështjen.
3. Më pas i jepet fjala stomatologut për të cilin është paraqitur ankesa, për të paraqitur prapësimet e tij/saj në lidhje me ankesën, si dhe nëse ka për të paraqitur, apo dorëzuar prova të tjera në lidhje me çështjen.
4. Komisioni Disiplinor rajonal mund të vendosë që palët sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni të dëgjohen veç e veç, nëse i shërben mbarëvajtjes së procesit.
5. Relatori i çështjes, pasi dëgjon palët, nëse e sheh të nevojshme, kërkon detajime të mëtejshme nga palët pjesëmarrëse në procedurë, si dhe në rast se e vlerëson të rastit, bën përpjekje për zgjidhjen me mirëkuptim të ankesës së paraqitur.
6. Më pas u jepet fjala ekspertëve, në rast se janë thirrur të tillë.

7. Kryetari iu kërkon anëtarëve të Komision nëse kanë pyetje për palët në gjykim, si dhe për ekspertët.
8. Nëse gjatë seancës paraqiten kërkesa dhe Komisioni vendos për të realizuar verifikime plotësuese, Komisioni vendos ndërprerjen e seancës, duke e pasqyruar këtë në procesverbal, i cili firmoset nga anëtarët e komisionit. Seanca tjetër zhvillohet brenda 10 ditësh.
9. Para mbylljes së seancës dëgjimore u jepet fjala palëve në gjykim, në fillim palës ankuese, pastaj palës tjetër për të paraqitur pretendimet përfundimtare.
10. Në përfundim, Kryetari u komunikon pjesëmarrësve mbylljen e hetimit administrativ për procedurën disiplinore dhe tërheqjen e Komisionit Disiplinor për marrjen e vendimit për të.

Neni 14

Procesverbali i seancës

1. Në seancën dëgjimore nën kujdesin e sekretarit të këshillit rajonal një punonjës i administratës së USSH të nivelit rajonal, i caktuar nga Presidenti, mban procesverbalin, ku shënon pjesëmarrjen e palëve, të pjesëmarrësve të tjerë në seancë dhe në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet fjala e pjesëmarrësve në seancën dëgjimore. Seanca dëgjimore mund të regjistrohet në audio ose video.
2. Në asnjë rast dokumentacioni i depozituar në dosje nuk mund të nxirret jashtë ambienteve të Urdhrit, të fotokopjohet, të riprodhohet apo të bëhet publik nga anëtarët e Komisionit.

Neni 15

Njoftimi dhe prezenca e palëve në procedurën disiplinore

1. Palët në gjykim njoftohen në adresën e deklaruar në ankesë apo në regjistrin e USSH.
2. Gjatë procedurës disiplinore, nëse njëra nga palët mungon personalisht dhe nuk përfaqësohet në seancën dëgjimore nga personi i autorizuar për arsye të justifikuara, seanca shtyhet duke u caktuar një datë tjetër të afërt, e cila u komunikohet palëve.
3. Gjatë procedurës disiplinore mungesa e pajustificuar e palëve në këtë procedurë sjell si pasojë gjykimin në mungesë të tyre.

Neni 16

Pjesëmarrja në seancë dhe komunikimi me median

1. Për pjesëmarrjen e të ftuarve dhe të publikut në seancat e gjyimit disiplinor profesional, vendoset për çdo rast në mënyrë të veçantë nga Komisioni Disiplinor përkatës, duke marrë parasysh ruajtjen dhe respektimin e privatësisë për të gjitha palët e përfshira në procedurë.
2. Ndalohet dhënia e informacionit për mediat para së të shpallet vendimi përfundimtar nga Komisioni disiplinor përkatës.

Neni 17

Vendimmarrja në dhomë këshillimi

1. Diskutimi në dhomë këshillimi i Komisionit

- Disiplinor kryhet menjëherë pas seancës dëgjimore, pa praninë e pjesëmarrësve në proces.
2. Kryetari u kërkon anëtarëve të Komisionit Disiplinor të shprehin mendimin dhe të argumentojnë atë, për marrjen apo jo të masës ndëshkimore ndaj stomatologut ndaj të cilit zhvillohet procedura disiplinore.
 3. Pasi merr në konsideratë mendimet e anëtarëve të Komisionit, relatori paraqet propozimin e tij, i cili hidhet në votim të hapur „pro“ ose „kundër“.
 4. Anëtarëve të Komisionit Disiplinor nuk u lejohet abstenimi. Konsiderohet i miratuar propozimi që ka marrë shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Komisionit Disiplinor.
 5. Marrja e vendimit nga Komisioni Disiplinor nuk mund të shtyhet.
 6. Dispozitivi i shkruar nga relatori nënshkruhet nga të gjithë anëtarët. Anëtarët që kanë votuar kundër nënshkruajnë me shënimin përkatës. Dispozitivi depozitohet në sekretarinë e Urdhrit dhe regjistrohet në regjistrin përkatës.

Neni 18

Llojet e Masave disiplinore

1. Komisioni Disiplinor heton dhe gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara në seancë dëgjimore. Kur vërtetohet së anëtari ka kryer shkelje sipas nenit 4 kësaj Rregulloreje lidhur me ushtrimin e profesionit, ndaj tij jepen këto masa:

- a) Vërejtje me shkrim;
 - b) Vërejtje me paralajmërim;
 - c) Gjobë nga 15 000 deri në 100 000 lekë;
 - ç) Propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione shëndetësore, publike dhe private.
 - d) Pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Stomatologut deri në 3 (tre) vjet;
 - dh) Përjashtim nga Urdhri i Stomatologut për një periudhë deri në 3 (tre) vjet.
2. Masa ndëshkuese e parashikuar në shkronjën “dh” të pikës 1 sjell si rrjedhojë çregjistrim nga Regjistri i Stomatologeve të Rajonit dhe ai Regjistri Kombëtar, si dhe heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit për afatin e caktuar në vendimin e Komisionit Disiplinor.
 3. Përveç masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, Komisioni Disiplinor ka të drejtë t’i caktojë stomatologut, si masë plotësuese edhe kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese, të barabarta me 20 kredite.
 4. Gjoha e vendosur sipas shkronjës “c”, të pikës 1, derdhet në Buxhetin e Shtetit.

Neni 19

Kriteret për caktimin e llojit dhe të masës së dënimit

Në përzgjedhjen e llojit të dënimit dhe në caktimin e masës së tij, Këshilli Disiplinor merr parasysh:

- a) rrethanat e kryerjes së shkeljes;
- b) nëse stomatologu rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;
- c) rëndësinë e shkeljes së bërë;
- ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi i stomatologut.

Neni 20

Shqiptimi i vendimit

1. Shqiptimi i vendimit të Komisionit Disiplinor bëhet në seancë të hapur për palët dhe publikun.
2. Kryetari pasi fton të pranishmit të ngrihen në këmbë, lexon tekstin e vendimit të Komisionit Disiplinor dhe njofton palët për datën ku do t'u jepet kopja e vendimit me arsyetimin e plotë të Komisionit.
3. Dispozitivi i vendimit është sipas Shtojcës që i bashkëlidhet kësaj Rregulloreje.

Neni 21

Zbardhja e vendimit dhe ankimi

1. Relatori, duke u mbështetur në procesverbalin dhe në vendimin e marrë nga Komisioni i Disiplinor Profesional, e zbardh vendimin brenda 3 ditëve në 3 (tre) kopje, të cilin e firmosin Anëtarët e Komisionit Disiplinor Profesional dhe depozitohet në Protokollin e Këshillit Rajonal.
2. Vendimi i zbardhur, së bashku me shkresën përcjellëse të nënshkruar nga Presidenti i Këshillit Rajonal u dorëzohet palëve në procedurën

disiplinore, duke u komunikuar atyre se kundrejt këtij vendimi, brenda 15 ditëve kalendarike, mund të bëhet ankimim në Komisionin Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar.

3. Në raste me interes të veçantë Vendimi i Komisionit i njoftohet Ministrisë përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë, Këshillave Rajonale të USSH-së dhe institucioneve shëndetësore të vendit

KREU V

GJYKIMI NË KOMISIONIN DISIPLINOR PRANË KËSHILLIT KOMBËTAR

Neni 22

Ankimet dhe përmbajtja e tyre

1. Ankimet kundër vendimeve Komisioni Disiplinor Rajonal paraqiten në Komisionin Disiplinor të Këshillit Kombëtar të USSH brenda 15 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit të Komisionit Disiplinor Rajonal.
2. Në ankim duhet të tregohen:
 - a) palët ne procedurën disiplinore;
 - b) vendimi kundër të cilit bëhet ankim;
 - c) shkaqet për të cilat bëhet ankim;
 - ç) çfarë kërkohet me ankimin.
3. Bashkë me ankimin duhet të paraqiten:
 - a) kopje të ankimit dhe të dokumenteve të tjera,

aq sa janë personat që marrin pjesë në çështje si palë;

- b) prokura kur ankimi paraqitet nga avokati ose përfaqësuesi i palës. Në rast se ankimi nuk plotëson kushtet e mësipërme, Sekretari i Përgjithshëm i USSH njofton palën që të ndreqë të metat brenda 3 ditëve, në të kundërt ankimi i kthehet.

Neni 23

Caktimi i relatorit të çështjes dhe administrimi i dosjes

1. Ankimi regjistrohet menjëherë në Regjistrin e Ankesave të Këshillit Kombëtar të USSH.
2. Sekretari i Përgjithshëm i USSH, brenda 48 orësh nga mbërritja e ankimit ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor Rajonal, organizon shortin për përcaktimin e relatorit të çështjes.
3. Modalitetet e hedhjes së shortit për caktimin e relatorit përcaktohen me vendim të Këshillit Kombëtar.
4. Sekretari i Përgjithshëm i USSH merr masat e nevojshme administrative që dosja e procedurës disiplinore përkatëse pranë këshillit rajonal të transferohet menjëherë në zyrat qendrore të USSH.

Neni 24

Seanca dëgjimore në Komisionin Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar

Për zhvillimin e seancës dëgjimore në Komisionin

Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar zbatohen me analogji përcaktimet e bëra në nenet 11 deri 21 të kësaj Rregulloreje.

Neni 25

Vendimi i Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar

1. Komisioni Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar pasi shqyrton çështjen vendos:
 - a) lënien në fuqi të vendimit të Komisionit Disiplinor Rajonal;
 - b) ndryshimin e vendimit të Komisionit Disiplinor Rajonal dhe gjykimin në themel të çështjes;
 - c) prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes.
2. Ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar mund të bëhet ankim në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë brenda 45 ditë nga marrja e vendimit të arsyetuar.

Neni 26

Shlyerja e masës disiplinore

Masat disiplinore të dhëna ndaj stomatologut mund të shlyhen në qoftë se, brenda 1 viti nga dita e dhënies së tyre për shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 18, dhe brenda 3 vjetëve nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 1 të nenit 18 nëse ndaj të njëjtit stomatolog anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 27

Kallëzimi në organet e sistemit të drejtësisë

Kur gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore sipas kësaj Rregulloreje vërehen elementë të kryerjes së një veprë penale kryetari i komisionit disiplinor rajonal ose komisionit disiplinor pranë Këshillit Kombëtar njoftojnë menjëherë organet e sistemit të drejtësisë.

Neni 28

Shperblimi për pjesëmarrje

1. Të gjithë anëtarët e Komisioneve Disiplinore dhe ekspertët të përfshirë në verifikime dhe procese disiplinore, shpërblehen me honorare nga USSH, sipas mënyrës dhe tarifave të miratuara nga Këshilli Kombëtar.
2. Kur dërgohen me shërbime jashtë rrethit, ata përfitojnë shpenzime udhëtimi e dietë, sipas tarifave të përcaktuara nga Këshilli Kombëtar.

Neni 29

Dispozitë tranzitore

1. Organet e zgjedhura të gjykimit profesional vijnë në ushtrimin e veprimtarisë së tyre deri në përfundimin e mandatit sipas Vendimit të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë nr. 22, datë 2.11.2015.
2. Kryetarët aktualë të komisioneve disiplinore ia dorëzojnë detyrën respektivisht Presidentit të

USSH dhe Presidenteve të këshillave rajonale të USSH. Në rast se ka mosdakortësi në dorëzimin e kësaj detyrë Kryetari i zgjedhur i komisionit disiplinor vijon të qendrojë në detyrë deri në përfundimin e mandatit kohor të tij duke zbatuar pas datës 1 mars 2022 përcaktimet e bëra në këtë Rregullore.

3. Brenda 60 ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, këshillat rajonalë dhe Këshilli Kombëtar i USSH zgjedhin anëtarët zëvendësues për komisionet përkatëse disiplinore, sipas nenit 7, pika 4 të kësaj Rregulloreje.
4. Për ankimet ndaj stomatologëve të rregjistruara para datës 1 mars 2022 zbatohen procedurat e parashikuara në Vendimin e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë nr. 22, datë 2.11.2015.

Neni 30 **Shfuqizim**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Vendimi i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë nr. 22, datë 2.11.2015.

Neni 31 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën 1 mars 2022 dhe bëhet publike në websiten e USSH.